



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM ERZEN –TIRANË

Nr 5302/2 prot

Tiranë më, 24/12/2018

VENDIM

Nr. 34 Datë. 4/12/2018

PËR  
MIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI NGA  
HEC SELBA SUBJEKTIT "STARTEK" SH.P.K.

Në zbatim të ligjit nr 111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" te ndryshuar, përkatësisht të nenit 42 pika 3; Neni 50, pika 2, N.52 gërma c ; të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme ,dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimi për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore" si dhe të, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, " Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni", nenit 24, gërma "f ndryshuar me VKM 718 datë 12.10.2016" me propozim të A.B.U Ishëm Erzen për paisjen me autorizim miratim në parim të subjektit "STARTEK " SH.P.K. Këshilli i Basenit Ujor Ishëm Erzen,

V E N D O S I

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit "STARTEK " SH.P.K. me administrator **Z.Lulëzim Mehmetaj**, për përdorim të burimit ujor **në rrjedhën e sipërme të lumit Erzen** për prodhim energjie elektrike, në fshatin Shëngjergj bashkia Tiranë , Qarku Tiranë. Sipas studimit të paraqitur nga subjekti për **HEC SELBA** do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës së marrjes sistemi GAUSS-KRUGER:

**X – 44 16 440 ; Y –45 75 720 ; Z- 398**

Koordinatat e veprës së marrjes sistemi KRGJSH:

**X – 500048.235 ; Y –4575106.915 ; Z- 398**

Prurja mesatare : **Q mes= 2.964 m<sup>3</sup>/sek;**

Prurja ekologjike: **Q 355= 0.236 m<sup>3</sup>/sek;**

Sasia që do jepet në përdorim **Q llog= 3.360 m<sup>3</sup>/sek.**

Prurja që shkarkohet:  $Q_{\text{ilog}} = 3.360 \text{ m}^3/\text{sek.}$

Fuqia e instaluar  $E = 1930 \text{ Kw}$

Sasia e ujit që do të lihet për Bujqësinë - nuk ka kanale vaditëse të cilat kushtëzojnë përdorimin sasior të ujit

Numri i orëve që do të shfrytëzohet – 3820 ore ne vit.

2- Autorizimi përdorimit të rezerves ujore për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U Ishëm –Erzen për zbatimin e këtij vendimi.

### PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR ISHËM ERZEN

SEKRETAR

Dorina ÇAPUNI



KRYETAR

Suzana JAHOLLARI

